



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prilaps / Predato Received / Delivered	08.12.2021	1	viti god year
Organ / Rjeshta Organ / Jednica Org / Unit	SKPM8HCK	5885/2021	113



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

**A.nr.865/2021**

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Arben Mehmeti-anëtar dhe Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.165/2021 të datës 13.10.2021, të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi rruga "Lisi" nr.20, fshati Bardh i vogël, Komuna e Fushë Kosovës, kundër organit të punësimit/Komuna e Fushë Kosovës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 08.12.2021, mori këtë:

**V E N D I M**

- I. **DETYROHET** Kryetari i Komunës së Fushë Kosovës, që të bëjë shqyrtimin e ankesës të datës 03.09.2021 të parashtruar nga ankuesi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.
- II. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

**A r s y e t i m**

Ankuesi i punësuar në Komunën e Fushë Kosovës në pozitën „Udhëheqës i Auditimit të Brendshëm”, sipas Akt Emërimit pa afat me numër 730 të datës 07.07.2016, me gradën 6, me datën 03.09.2021 ka parashtruar ankesë tek Kryetari i Komunës dhe Komisioni për Ankesa dhe Parashtrësa në Komunën e Fushë Kosovës me pretendimin ankimor lidhur me unifikimin e koeficientit të pagës në nivelin e komunave respektivisht ka kërkuar unifikimin e pagës dhe koeficientit nga grada 15 në gradën 20 në nivelin e komunave tjera për pozitën e Drejtorit të Njësisë së Auditimit të Brendshëm.





I pakënaqur me mos përgjigjen nga ana organit të punësimit ankuesi me datën 13.10.2021 ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 5012/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër mos harmonizimit të pagës dhe koeficientit nga grada 15 në gradën 20 si dhe kundër heshtjes administrative nga ana e Komunës së Fushë Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datën 18.10.2021, e ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankueses tek Komuna e Fushë Kosovës, ndërsa me datën 26.10.2021, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Fushë Kosovës me shkresat e bashkangjitura.

**Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën me numër të protokollit 5012/2020 të datës 13.10.2021 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesë e ankuesit e datës 03.09.2021, e parashtruar nga ankuesi për komisionin komunal për ankesa dhe parashtrësja; Kontratë e punës së ankuesit e datës 31.12.2009; Akt emërim i ankuesit i datës 01.06.2011; Akt emërim i ankuesit i datës 01.07.2016; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 18.10.2021 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigja në ankesë e datës 26.10.2021 nga Komuna e Fushë Kosovës me shkresat e bashkangjitura; Kërkesa për prova shtese e datës 22.11.2021 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigja në kërkesë e datës 23.11.2021 nga Udhëheqësja e Personelit në Komunën e Fushë Kosovës; Vendim me numër VK.nr.57/2021 i datës 23.11.2021 për vazhdimin e afatit të ankesës në Këshill.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave për vendosjen e kësaj çështje, duke u bazuar në nenin 16 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e parashtruara të lëndës dhe ka konstatuar që ekziston baza ligjore për të vendosur, duke *obliguar* organin e punësimit, respektivisht Kryetarin e Komunës së Fushë Kosovës që ti ndërmarr të gjitha veprimet, për të vendosur lidhur me ankesën e datës 03.09.2021 të parashtruar nga ankuesi

*sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit të shkresave të lëndës, ka konstatuar se ankuesi marrëdhënien e punës fillimisht e ka themeluar me datën 30.12.2008 me nënshkrimin e Kontratës me numër 111/08 në pozitën „Drejtor i Auditimit“ në Komunën e Fushë Kosovës, i cili ka vazhduar të ushtroj këtë detyre deri me datën 29.03.2012 kur e ka nënshkruar Akt emërimin me numër 106 të datës 29.02.2012 për pozitën „Auditor i brendshëm“, me grade 15, ndërsa me datë 07.07.2016, ankuesi e ka nënshkruar Akt emërimin me numër 730 për pozitën „Udhëheqës i Auditimit të Brendshëm“ në Komunën e Fushë Kosovës me grade 6.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha dëshmitë e ofruara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankuesi më datë 03.09.2021 ka parashtruar ankesë tek Kryetari i Komunës së Fushë Kosovës dhe Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, me pretendimin ankimor lidhur me unifikimin e koeficientit të pagës në nivelin e komunave respektivisht ka kërkuar unifikimin e pagës dhe koeficientit nga grada 15 në gradën 20 nga vitit 2012 në nivelin e komunave tjera për pozitën e Drejtorit të Njësisë së Auditimit të Brendshëm, mirëpo gjithnjë duke u bazuar në provat e lëndës





Kolegji ka konstatuar se deri me tani Kryetari i Komunës së Fushë Kosovës nuk e ka shqyrtuar ankesën e ankuesit të datës 03.09.2021.

Andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në pajtim me dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative konkretisht nën 135 paragrafi 1, me të cilin përcaktohet se: "Përpos kur ligji parashih një afat të ndryshëm, akti administrativ që zgjidh ankesën do të nxirret dhe njoftohet palës brenda tridhjetë (30) ditëve nga parashtrimi i ankesës", konstaton se mbi bazë të kësaj Kryetari i Komunës së Fushë Kosovës ka qenë i obliguar për shqyrtimin e ankesës së ankuesit në pajtim me legjislacionin në fuqi, si dhe ta njoftoj ankuesin me shkrim lidhur me ankesën e tij.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në faktet e lartcekura, konstaton se Kryetari i Komunës së Fushë Kosovës, është i obliguar që në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ligjeve të aplikueshëm që kanë të bëjnë me pozitën që mban ankuesi, të shqyrtoj kërkesën e ankuesit të datës 03.09.2021 si dhe të nxjerr akt administrativ në pajtim me procedurat ligjore, brenda afatit të përcaktuar si në pikën 1 të dispozitivit të këtij vendimi.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në diapozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**  
Lënda me numër 865/2021

Ardita Peçuku-Shtyri

Procesmbajtëse

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Fushë Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Fushë Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së .